



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**  
**Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë**  
**www.uni-gjilan.net tel: 0280390112**

Këshilli Drejtues: Tech. Dr. Ilir Gjinolli, Kryesues i KD Ref.nr. 02/2253/03/11/2023

Këshilli Drejtues i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, në mbledhjen XXVII të mbajtur më datë 31.10.2023, mori vendim të shpall:

### **KONKURS**

**Për ndarjen e bursave universitare për nivelin baçelor dhe master për vitin akademik 2022/23**

**I. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët e nivelit baçelor dhe master të cilët i plotësojnë këto kushte:**

1. Të jenë studentë të rregullt;
2. Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë;
3. Të mos kenë vit të përsëritur;
4. Të kenë të përfunduara të gjitha provimet e vitit paraprak të studimeve në afatin e shtatorit.

**II. Studentët duhet plotësuar edhe kriteret shtesë të aprovuara nga KD dhe atë:**

- Studentët e Fakultetit të Edukimit, Fakultetit Ekonomik dhe Fakulteti Juridik si dhe programi master E-Qeverisje duhet të kenë notën mesatare së paku 9.00;
- Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Fakulteti i Shkencave Aplikative duhet të kenë notën mesatare më së paku 8.50.

**III. Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2023 e ka përcaktuar shumën e burses në vlerë prej 800.00 euro.**

**IV. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika I dhe pika II e konkursit duhet të paraqesin këto dokumente:**

- Formularin e plotësuar (shkarkohet nga ueb faqja zyrtare e universitetit);
- Vërtetimin për statusin e studentit (lëshohet nga fakulteti);
- Pasqyrën e provimeve të dhëna (lëshohet nga fakulteti);
- Letërnjoftimin kopje;
- Vërtetimim e llogarisë bankare.

**V. Afatet e konkursit**

- Aplikimi për bursë universitare bëhet nga datat **06.11.2023** deri më **10.11.2023** ora 15:00.
- Dorëzimi i dokumenteve bëhet në fakultetin përkatës.

